



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.202

dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i METE dhe MF nr.7643/3, datë 8.12.2009	Për tarifat dhe pagesat e Shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë	9785
Udhëzim i METE nr.1028, datë 10.12.2009	Për përmbajtjen e dokumentacionit për pajisje me leje minerare	9798

UDHËZIM
Nr.7643/3, datë 8.12.2009

**PËR TARIFAT DHE PAGESAT E SHËRBIMEVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 63 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Personat fizikë ose juridikë, që prodhojnë, importojnë ose përdorin instrumente matëse për shërbimet e kryera nga DPM për llogari të tyre, janë të detyruar të paguajnë tarifën dhe pagesat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Për miratimin e tipit të instrumentit matës ose për lejimin e atyre që importohen, përdoren tarifën e përcaktuara në pasqyrën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.1 Nëse tipi i instrumentit matës të paraqitur për miratim nuk përputhet me kërkesat teknike-metrologjike të regjistruara, procedura e punës ndërpritet dhe subjekti paguan tarifën e shënuar në germën “a” dhe gjysmën e tarifës së shënuar në germën “b” të pikës 1 të pasqyrës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.2 Tarifën e miratimit të tipit paguhet edhe kur tipi i instrumentit matës në përfundim nuk plotëson kërkesat për miratim.

2.3 Kur importohen instrumente matëse, zbatohen tarifën e përcaktuara në pikën 2 të pasqyrës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Për regjistrimin e instrumenteve matëse, zbatohen tarifën e përcaktuara në pasqyrën nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Për verifikimin periodik të instrumenteve matëse, zbatohen pagesat e përcaktuara në pasqyrën nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Për verifikimin fillestar të instrumenteve matëse, do të paguhet tarifën sa dyfishi i tarifave për verifikimin periodik (të dhëna në pasqyrën nr.3).

6. Për kalibrimin e instrumenteve matëse zbatohen pagesat e përcaktuara në pasqyrën nr.4, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Për rastet kur kërkohet kopje (dublikate) e certifikatës/raportit të kalibrimit, paguhet vlera fikse prej 500 lekësh.

7. Pagesat e verifikimit fillestar ose periodik, si dhe pagesat e kalibrimit llogariten për copë, për çdo pronar ose administrues të marrë veç e veç, si dhe për instrumente matëse të të njëjtit tip dhe që verifikohen ose kalibrohen në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë.

8. Kur sasia e instrumenteve matëse të të njëjtit tip, që verifikohet ose kalibrohet është më e madhe se një copë, pagesa llogaritet nga produkti i pagesës përkatëse për copë me numrin e copëve të këtij tipi instrumentit matës, kur nuk paraqitet ndryshe në pasqyrën përkatëse.

9. Kur puna verifikuese ose kalibruuese ndërpritet për shkak të pronarit ose administruesit, pagesa për copë llogaritet mbi bazën e numrit të instrumenteve matëse që janë verifikuar ose kalibruar faktikisht nga ai tip.

10. Personi fizik ose juridik, që kërkon të kryejë verifikimin ose kalibrimin e instrumenteve matëse që disponon në vend përdorimit të tyre, përballon dhe shpenzimet shtesë të mëposhtme:

10.1 Për peshoret hekurudhore, automobilistike dhe ato me platformë për transportin e bazës etalonuese:

- për largësi të vendndodhjes së peshores që verifikohet deri 40 km nga DPM, shpenzimet shtesë merren në vlerë fikse prej 5000 lekësh;

- për largësi të vendndodhjes së peshores (që verifikohet ose kalibrohet) mbi 40 km, shpenzimet shtesë përcaktohen nga produkti i largësisë në km i vendndodhjes së saj nga DPM, me tarifën 120 lekë/km.

10.2 Për vagoncisternat, autobotët dhe rezervuarët:

- materialet e nevojshme ndihmëse;
- pagesën për shfrytëzimin e peshores së përdorur për verifikim.

10.3 Për transportin e pajisjeve dhe të specialistëve, në rastet kur kalibrimi kryhet në vendpërdorim.

10.4 Për të gjitha rastet e tjera kur shërbimi i verifikimit të instrumenteve matëse kryhet në vendpërdorim, do të merret një shtesë prej 20 % të tarifës përkatëse të paraqitur në pasqyrën nr.3. Bëjnë përjashtim të gjitha instrumentet matëse, verifikimi i të cilave kryhet vetëm në vendpërdorim sipas pikës 3 të nenit 27 të ligjit për metrologjinë (për rastet kur një instrument matës ligjërisht i kontrolluar, për shkak të konstruksionit është i lidhur me vendin e instalimit).

10.5 Për të gjitha rastet e tjera kur shërbimi i kalibrimit të instrumenteve matëse kryhet në vendpërdorim, do të merret një shtesë prej 20 % e tarifës përkatëse të paraqitur në pasqyrën nr.4.

11. Për rastet kur personi fizik ose juridik ka rënë dakord me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për vendin dhe kohën e kryerjes së kalibrimit dhe puna nuk mund të fillojë, nuk mund të vazhdojë ose fillon me vonesë, pasi personi fizik ose juridik nuk i ka realizuar ose i ka realizuar me mangësi detyrimet e tij për përgatitjen paraprake, paguhet pagesa sipas pasqyrës nr.5, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

12. Kur personi fizik ose juridik njofton për moszbatimin e planifikimit të kalibrimit të instrumenteve matëse, ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka filluar punën përgatitore për kryerjen e kalibrimit, paguhet pagesa sipas pasqyrës nr.5, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

13. Kur instrumentet matëse të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për verifikim ose kalibrim nuk tërhiqen nga prurësi brenda afateve të caktuara (1 muaj nga data e ardhjes së instrumenteve matëse), ky i fundit i paguan Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për magazinim, një shtesë 1% të pagesës përkatëse të verifikimit ose kalibrimit, për çdo instrument matës, për çdo ditë.

14. Kur procesi i miratimit, njohjes së miratimit të tipit, regjistrimit apo verifikimit ose kalibrimit të instrumenteve matëse zgjat më shumë se afati i parashikuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Metrologjisë, komunikohet me klientin për arsyt dhe afatet e shtyrjes së shërbimit personit fizik ose juridik i zbritet 1% e tarifës ose pagesës përkatëse për çdo ditë vonesë dhe për çdo mjet.

15. Për kontrollin e produkteve të paketuara, paguhen tarifat e miratuara sipas pasqyrës nr.6 të këtij udhëzimi.

16. Për kryerjen e procedurave të autorizimit të subjekteve që kryejnë shërbime në fushën e metrologjisë ligjore, si dhe të inspektimit vjetor të tyre, miratohen tarifat e përcaktuara në pasqyrën nr.7 të këtij udhëzimi.

17. Për shërbimet, të cilat nuk përfshihen në pasqyrat bashkëlidhur, tarifa ose pagesa do të përllogaritet me kohën e punës në orë, të nevojshme për shërbimin e kryer, shumëzuar me tarifën 1 500 lekë.

18. Në tarifat dhe pagesat e parashikuara në këtë udhëzim është përfshirë edhe TVSH-ja.

19. Mënyra e klasifikimit dhe e përdorimit të të ardhurave që krijohen gjatë ushtrimit të funksioneve në DPM, në zbatim të ligjit nr.9875 datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.432, datë 28.6.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, me një udhëzim në zbatim, të këtij vendimi.

20. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJITIKËS
Dritan Prifti

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

PASQYRA NR.1
TARIFAT PËR PROCEDURAT E MIRATIMIT TË TIPIT TË INSTRUMENTIT MATËS

1. Për prodhimin në vend të instrumenteve matëse
 - a) Për shqyrtimin dhe pranimin e dokumenteve për miratimin e tipit:

- Instrumente matëse	6000 lekë
- Per sisteme matëse	12 000 lekë.
 - b) Për verifikimin e treguesve teknikë dhe metrologjikë të tipit, paguhet sa dyfishi i vlerës së përcaktuar në pasqyrën nr.3 të këtij vendimi. Për raste kur instrumenti matës nuk është i cilësuar në pasqyrën nr.3, bashkëngjitur këtij udhëzimi, pagesa bëhet në zbatim të pikës 18 të udhëzimit.
 - c) Për shpalljen e miratimit të tipit ose njohjes së miratimit të tipit:

- Për çdo faqe të daktilografuar	100 lekë
- Për çdo skemë	200 lekë
- Për çdo fotografim	500 lekë.
 - d) Nëse mostra e paraqitur nuk përputhet me kërkesat teknike të përcaktuara, procedura e punës ndërpritet dhe subjekti paguan tarifën e pikës “a” dhe gjysmën e tarifës së pikës “b”.
2. Për instrumentet matëse të importuara:
 - a) Për shqyrtimin e dokumentacionit të miratimit të tipit:

- Instrumente matëse	6 000 lekë
- Sisteme matëse	12 000 lekë.
 - b) Kur është e nevojshme kryerja e testimeve për verifikimin e përmbushjes së treguesve teknikë dhe metrologjikë të tipit paguhet sa dyfishi i vlerës së përcaktuar në pasqyrën nr.3 të këtij vendimi. Për raste kur instrumenti matës nuk është i cilësuar në pasqyrën nr.3, bashkëngjitur këtij udhëzimi, pagesa bëhet në zbatim të pikës 18 të udhëzimit.

PASQYRA NR.2
TARIFAT E REGJISTRIMIT TË INSTRUMENTEVE MATËSE

1. Regjistrimi i instrumenteve matëse

- Për çdo instrument matës apo lodër fati	100 lekë
- Për gramare ose masa vëllimore seri, deri në 5 copë	100 lekë
- Për çdo gramar ose masë vëllimore shtesë	50 lekë.

PASQYRA NR.3
PAGESA PËR VERIFIKIM PERIODIK TË INSTRUMENTEVE MATËSE

- | 1. Matësit materialë të gjatësisë | Lekë për copë |
|---|---------------|
| 1.1 Metra | |
| - deri në 1 m | 600 |
| - mbi 1 m | 800. |
| 1.2 Metra shirit | |
| - deri në 5 m | 1200 |
| - mbi 5 m deri 50 m | 3000 |
| - mbi 50 m | 7500. |
| 1.3 Për sasi mbi 5 copë instrumente matëse të pikave 1.1 dhe 1.2, bëhet zbritja si më poshtë: | |
| - nga 6 copë deri në 10 copë | 10 % |
| - mbi 10 copë | 20 %. |

2. Masa vëllimore për lëndë të thata, vëllimi i të cilave del me përlogaritje	Lekë për copë
2.1. Masë vëllimore	3000
- një nënndarje e masës vëllimore	1500
- çdo nënndarje tjetër shtesë	1000.
3. Masa vëllimore për lëngje në të cilat është shënuar kufiri i vëllimit ose është caktuar kapaciteti deri në buzë (përfshirë masat e kapacitetit të shërbimit). (bëjnë përjashtim pikat 5 dhe 6)	

3.1 Verifikim vëllimi	Numri i copëve	Lekë për copë
deri 1 dm ³	deri në 5	350
	6 deri 10	320
	mbi 10 deri 100	300
mbi 1 dm ³ deri në 5 dm ³	deri në 5	450
	6 deri 10	400
	mbi 10	350
mbi 5 dm ³ deri 10 dm ³	deri në 5	700
	6 deri 10	600
	mbi 10	500
mbi 10 dm ³ deri 20 dm ³	deri në 5	1000
	6 deri 10	800
	mbi 10	700
mbi 20 dm ³ deri 50 dm ³	deri në 5	1600
	6 deri 10	1400
	mbi 10	1000
mbi 50 dm ³ deri 100 dm ³	deri në 5	2000
	6 deri 10	1800
	mbi 10	1600
4. Masa vëllimore qelqi dhe porcelani me vëllim deri në 5 dm ³ lekë për copë		
1 dm ³	deri 5	500
	6 deri 10	400
	mbi 10	300
mbi 1 dm ³ deri 5 dm ³	deri 5	600
	6 deri 10	500
	mbi 10	400.

Për masa qelqi jo të tejdukshme dhe porcelani, pagesa e verifikimit të tyre është sa dyfishi i atyre të vendosura në këtë pikë.

5. Masa vëllimore, si voza, damixhanë, shishe me vëllim mbi 5 dm³, rezervuarë, autobot (vagonçistern).

5.1 Voza, damixhane, shishe, rezervuarë	Lekë për copë
Verifikim vëllimi	
deri 50 dm ³	1500
mbi 50 dm ³ deri 100 dm ³	1800
mbi 100 dm ³ deri 200 dm ³	2400
mbi 200 dm ³ deri 300 dm ³	3000
mbi 300 dm ³ deri 400 dm ³	3500
mbi 400 dm ³ deri 500 dm ³	4000
mbi 500 dm ³ deri 600 dm ³	4500
mbi 600 dm ³ deri 700 dm ³	5000
mbi 700 dm ³ deri 800 dm ³	6000
mbi 800 dm ³ deri 900 dm ³	6500

mbi 900 dm³ deri 1000 dm³ 7000.

Për verifikimin e vozave prej druri, nëse janë të nevojshme punët plotësuese (fshirja e shënimeve të mëparshme, etj), pagesa rritet 25 % e pagesës përkatëse të pikës 5.1.

5.2 Kur verifikimi i enëve vëllimore të pikës 5.1 bëhet në vendpërdorim (birrari, punishte, etj.) dhe pronari ose administruesi vë në dispozicion pajisjet e nevojshme dhe kryen punët ndihmëse, pagesa ulet me 40 % të pagesës përkatëse të vendosur në pikën 5.1.

5.3 Autobote (cisterna rrugore) dhe rezervuarë

Verifikim vëllimi

deri 5000 dm ³	8 400
mbi 5000 dm ³ deri 10 000 dm ³	9 600
mbi 10 000 dm ³ deri 15 000 dm ³	11 000
mbi 15 000 dm ³ deri 20 000 dm ³	12 000
mbi 20 000 dm ³ deri 25 000 dm ³	13 200
mbi 25 000 dm ³ deri 30 000 dm ³	14 400
mbi 30 000 dm ³	15 600.

5.4 Vagoncsiterna

Verifikim vëllimi

deri 25 000 dm ³	19200
mbi 25 000 dm ³	24000.

5.5 Për verifikimin e enëve vëllimore, autoboteve (cisternave rrugore) me shumë nënndarje (gryka mbushje) të veçanta, të ndara nga njëra-tjetra, kur verifikimi i nënndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, pagesës për kapacitet të plotë të enës vëllimore të autobotit, i shtohet pagesa prej 50 % për verifikimin e vëllimit përkatës të çdo nënndarjeje (grykë mbushje) të dhëna në pikat 5.1, 5.3 e 5.4.

6. Aparate të shpërndarjes së karburanteve lekë për copë

6.1 Aparate të shpërndarjes së karburanteve dhe LPG për automjete

deri 6 copë	7200
nga 7 deri 12 copë	7000
mbi 12 copë	6500.

6.2 Njëhsore-kontalitra të pikave të shitjes me shumicë, të autobotëve ,etj

deri 1000 l /min (për autobotë)	8 000
mbi 1000 l/min	16 000.

7. Gramare në përputhje me R111(2004) të OIML

Lekë për copë

7.1 Klasa M₃

deri 200 g	100
500 g	110
1kg, 2kg	120
5 kg	180
10 kg	220
20 kg	260
50 kg	400
500 kg	3200
1000 kg	5000.

7.2 Gramare, klasa e saktësisë M₁ dhe M₂ (klasa M₂ duke filluar nga 100mg)

Për verifikimin e gramareve të klasave M₁ dhe M₂ paguhet dyfishi i pagesës përkatëse të dhënë në pikën 7.1.

7.3 Gramare klasa F2

Për verifikimin e gramareve të klasës F2, pagesa është sa trefishi i dhënë në pikën 7.1 (klasa F2 deri 50 kg)

7.4 Gramare jo në përputhje me R111(2004) të OIML dhe gramare me masë nominale të lirë.

Për verifikimin e gramareve jo në përputhje me R111(2004) të OIML dhe gramare me masë nominale të lirë, tarifa është dyfishi i pagesës përkatëse të dhënë në pikën 7.1.

8. Peshore	Lekë për copë
8.1 Peshore analitike dhe saktësie (klasa II)	
analitike	4000
saktësie	2000
8.2 Peshore joautomatike mekanike (klasa III)	
deri 1 kg	800
mbi 1 kg deri 35 kg	1200
mbi 35 kg deri 300 kg	2400
mbi 300 kg deri 1000 kg	4000
8.3 Peshore joautomatike elektronike (klasa III)	
deri 1 kg	1200
mbi 1 kg deri 35 kg	1700
mbi 35 kg deri 300 kg	2200
mbi 300 kg deri 1000 kg	4200
8.4 Peshore joautomatike (klasa III)	
mbi 1000 kg deri 5000 kg	6 000
mbi 5 t deri 10 t	10 000
mbi 10 t deri 60 t	19 000
mbi 60 t deri 80 t	22 000
mbi 80 t deri 120 t	24 000
mbi 120 t	30 000.

8.5 Peshore gjysmëautomatike (hopper - që përdoren në linjat e prodhimit të betoneve në mënyrë joautomatike) do të aplikohen tarifa sa 1.3 e tarifave të verifikimit të peshoreve jo automatike të tonazhit përkatës

9. Instrumente matës të fushës, të presionit	Lekë për copë
9.1 Matësit e presionit të gomave të automjeteve	700
9.2 Manometra	2 000
10. Taksimetra	3 200
11. Sisteme matëse të forcës së makinave testuese një aksiale të materialeve	lekë për copë
11.1 Makina të provave materiale, diapazon 0 deri 100 kN	16 000
11.2 Makina të provave materiale, diapazon 0 deri 3000 kN	30 000.

PASQYRA 4
PAGESA PËR KALIBRIM TË INSTRUMENTEVE MATËSE

1. Instrumente matëse të forcës, presionit, fortësisë	Lekë për copë
1.1 Makina e provave materiale 10- 3000 kN	35 000
1.2 Makina e provave materiale 0 - 100kN	20 000
1.3 Manometër	8 000
1.4 Makina të provave të fortësisë	10 000
2 Mjete matëse të volumeve dhe rrjedhjeve	
2.1 Enë volumore deri 20 litra	9 000
2.2 Enë volumore deri 50 litra	9 500
2.3 Cilindër	3 000
2.4 Ballon	3 000
2.5 Pipete	3 000
2.6 Piknometër	3 000.
2.7 Njëhsore-kontalitra të pikave të shitjes me shumicë, të autoboteve etj.	
- deri 1000 l /min (për autobote)	14 000
- mbi 1000 l/min	30 000.

2.8 Gjatë procesit të kalibrimit të enëve volumore, autoboteve dhe rezervuarëve paguhet tarifa e mëposhtme sipas volumeve:

Rezervuarë	
- Kapaciteti 2000 m ³ , tarifa bazë	600 000 lekë
- Për çdo ulje kapaciteti me 500 m ³ nga 2000 m ³ , do të bëhet një ulje e tarifës bazë me	20 000 lekë
- Për çdo shtesë me 1000 m ³ mbi kapacitetin 2000 m ³ , do të bëhet një rritje e tarifës bazë me	40 000 lekë
- Për kapacitete nën 500 m ³ do të bëhet pagesa për çdo nëndarje 10 cm në vlerën	6 500 lekë/10 cm.

Shënim. Vlera 6500 lekë/10 cm e parashikuar në pikën “d” do të aplikohet për cilindra vertikalë me kapacitet më të vogël se 500 m³ vetëm në rastin kur kjo vlerë nuk kalon vlerën e tarifës për 1 cilindër me kapacitet të barabartë me 500 m³.

- Kur një subjekt në të njëjtën kohë kërkon që të kalibrojë disa rezervuarë, autobote apo enë volumore që ndodhen në të njëjtin vend, tarifa për mjetin e parë do të merret e plotë, ndërsa për të tjerët do të merret 0.8 e tarifës përkatëse.

3. Instrumente matëse të masës	Lekë për copë
3.1 Gramare	
3.1.1 Gramare klasa M3	
- 1g – 50g	1 500
- 100g – 500g	1 600
- 1kg – 5kg	1 700
- 10kg	1 800
- 20kg	2 000
- 50kg	2 500.

Seri gramarësh klasa M3

- 1g – 500g	12 copë	8 000
- 1g – 1kg	13 copë	8 500
- 1g – 2kg	15 copë	9 000
- 1g – 5kg	16 copë	9 500
- 1g – 10kg	17 copë	10 000.

3.1.2 Gramar klasa M2

- 100mg – 500mg		1 500
- 1g – 50g		1 500
- 100g – 500g		1 600
- 1kg – 5kg		1 700
- 10kg		1 900
- 20kg		2 200
- 50kg		3 000.

Seri gramarësh klasa M2

- 100mg – 500mg	4 copë	4 000
- 100mg – 50g	12 copë	11 500
- 100mg – 100g	13 copë	12 000
- 100mg – 200g	15 copë	13 000
- 100mg – 500g	16 copë	14 000
- 100mg – 1kg	17 copë	15 000
- 100mg – 2kg	19 copë	16 000
- 100mg – 5kg	20 copë	17 000
- 100mg – 10kg	21 copë	18 000
- 1g – 50g	8 copë	9 000
- 1g – 100g	9 copë	9 500
- 1g – 200g	11 copë	12 000
- 1g – 500g	12 copë	12 500
- 1g – 1kg	13 copë	13 000
- 1g – 2kg	15 copë	14 500
- 1g – 5kg	16 copë	15 000
- 1g – 10kg	17 copë	15 500.

3.1.3 Gramar klasa M1

- 1mg – 500mg		1 600
- 1g – 50g		1 600
- 100g – 500g		1 700
- 1kg – 5kg		1 800
- 10kg		2 000
- 20kg		2 200
- 50kg		3 000.

Seri gramarësh klasa M1

- 1mg – 500mg	12 copë	12 000
1mg – 50g	- 20 copë	14 000
- 1mg – 100g	21 copë	14 500
- 1mg – 200g	23 copë	15 500
- 1mg – 500g	24 copë	16 500
- 1mg – 1kg	25 copë	17 500
- 1mg – 2kg	27 copë	19 500
- 1mg – 5kg	28 copë	21 000
- 1mg – 10kg	29 copë	22 000
- 1g – 50g	8 copë	9 500
- 1g – 100g	9 copë	10 500
- 1g – 200g	11 copë	12 500
- 1g – 500g	12 copë	13 000
- 1g – 1kg	13 copë	13 500
- 1g – 2kg	15 copë	14 500
- 1g – 5kg	16 copë	15 000
- 1g – 10kg	17 copë	16 500.

3.1.4 Gramar klasa F2

- 1mg – 500mg	1 800
- 1g – 50g	1 800
- 100g – 500g	2 200
- 1kg – 5kg	2 700
- 10kg	3 000
- 20kg	3 500
- 50kg	4 000.

Seri gramarësh klasa F2

- 1mg – 500mg	12 copë	13 000
- 1mg – 50g	20 copë	16 000
- 1mg – 100g	21 copë	17 500
- 1mg – 200g	23 copë	19 000
- 1mg – 500g	24 copë	20 500
- 1mg – 1kg	25 copë	22 000
- 1mg – 2kg	27 copë	25 500
- 1mg – 5kg	28 copë	27 000
- 1mg – 10kg	29 copë	29 000
- 1g – 50g	8 copë	11 000
- 1g – 100g	9 copë	12 000
- 1g – 200g	11 copë	13 500
- 1g – 500g	12 copë	14 500
- 1g – 1kg	13 copë	15 500
- 1g – 2kg	15 copë	18 500
- 1g – 5kg	16 copë	20 500
- 1g – 10kg	17 copë	22 500.

3.1.5 Gramar klasa F1

- 1mg – 500mg	2 000
- 1g – 50g	2 100
- 100g – 500g	2 500
- 1kg – 5kg	3 500
- 10kg	4 200
- 20kg	5 500
- 50kg	6 500.

Seri gramarësh klasa F1

- 1mg – 500mg	12 copë	15 000
- 1mg – 50g	20 copë	18 000
- 1mg – 100g	21 copë	19 500
- 1mg – 200g	23 copë	21 000
- 1mg – 500g	24 copë	22 500
- 1mg – 1kg	25 copë	24 000
- 1mg – 2kg	27 copë	27 500
- 1mg – 5kg	28 copë	29 000
- 1mg – 10kg	29 copë	32 000
- 1g – 50g	8 copë	12 500
- 1g – 100g	9 copë	13 500
- 1g – 200g	11 copë	16 500
- 1g – 500g	12 copë	18 500
- 1g – 1kg	13 copë	19 500
- 1g – 2kg	15 copë	21 500
- 1g – 5kg	16 copë	23 500
- 1g – 10kg	17 copë	25 500.

3.1.6 Gramar klasa E2

- 1mg – 500 mg	3 500
- 1g – 50 g	3 500
- 100g – 500 g	4 500
- 1kg – 5 kg	5 500
- 10 kg	6 000
- 20 kg	7 500
- 50 kg	8 000.

Seri gramarësh klasa E2

- 1mg – 500 mg	12 copë	20 000
- 1mg – 50 g	20 copë	30 000
- 1mg – 100 g	21 copë	33 500
- 1mg – 200 g	23 copë	38 000
- 1mg – 500 g	24 copë	41 500
- 1mg – 1 kg	25 copë	44 000
- 1mg – 2 kg	27 copë	49 500
- 1mg – 5 kg	28 copë	55 000
- 1mg – 10 kg	29 copë	60 000

- 1g – 50 g	8 copë	13 500.
- 1g – 100 g	9 copë	15 500
- 1g – 200 g	11 copë	19 500
- 1g – 500 g	12 copë	22 500
- 1g – 1 kg	13 copë	26 500
- 1g – 2 kg	15 copë	32 500
- 1g – 5 kg	16 copë	38 500.

3.1.7 Gramar klasa E1

- 1mg – 500 mg		16 500
- 1g – 50 g		16 500
- 100g – 500 g		22 500
- 1kg – 5 kg		35 500
- 10 kg		38 500
- 20 kg		54 500
- 50 kg		66 500.

Seri gramarësh klasa E1

- 1mg – 500 mg	12 copë	60 000
- 1mg – 50 g	20 copë	240 000
- 1mg – 100 g	21 copë	255 500
- 1mg – 200 g	23 copë	280 000
- 1mg – 500 g	24 copë	290 500
- 1mg – 1k g	25 copë	310 000
- 1mg – 2 kg	27 copë	230 500
- 1mg – 5 kg	28 copë	240 000
- 1mg – 10 kg	29 copë	255 000
- 1g – 50 g	8 copë	185 500
- 1g – 100 g	9 copë	195 500
- 1g – 200 g	11 copë	205 500
- 1g – 500 g	12 copë	212 500
- 1g – 1 kg	13 copë	216 500
- 1g – 2 kg	15 copë	222 500
- 1g – 5 kg	16 copë	255 500
- 1g – 10 kg	17 copë	285 500.

Shënim. Kur numri i serisë së gramarëve për kalibrim është më shumë së një, vlera e kalibrimit për serinë pasardhëse ulet me 20% referuar përcaktimeve të mësipërme.

3.2 Peshore

3.2.1 Peshore joautomatike:

- klasa e I e saktësisë		15 000
- klasa e II e saktësisë		12 000
- klasa e III e saktësisë	kapacitet deri 35 kg	9 000
- klasa e III, IIII e saktësisë	nga 35 kg deri 100 kg	15 000
- klasa e III, IIII e saktësisë	nga 100 deri 300 kg	25 000
nga 300 kg deri 1000 kg		45 000
mbi 1000 kg deri 5000 kg		60 000
mbi 5000 kg deri 10000 kg		90 000
mbi 10 t deri 40 t		100 000
mbi 40 t deri 60 t		125 000
mbi 60 t deri 80 t		135 000
mbi 80 t deri 120 t		145 000
mbi 120 t		160 000.

Kur numri peshoreve që kalibrohen në të njëjtën kohë në një subjekt është më i madh se një, vlera e kalibrimit për çdo peshore shtesë ulet me 10 %.

Për peshore më shumë diapazonë matjeje, pagesa e kalibrimit, për çdo diapazon matje shtohet me 40% të vlerës së përcaktuar më sipër.

3.2 Peshore automatike

- deri 5 kg	20 000
- mbi 5 kg deri 50 kg	30 000
- mbi 50 kg	50 000.

4. Instrumente matëse elektrike

Lekë/copë

4.1 Elemente normale	6 000
4.2 Rezistenca kampione	4 000
4.3 Aparate elektrike të tensionit, të rrymës, të fuqisë, të këndit, humbjeve elektrike, të frekuencës, rezistencës etj., për çdo diapazon matjeje, klasa jo më e mirë se 0.5%	1 000
4.4 Aparate elektrike të tensionit, të rrymës, të fuqisë, të këndit, humbjeve elektrike, të frekuencës, rezistencës, etj., për çdo diapazon matjeje, klasa jo më e mirë se 0.5%	2 000
4.5 Aparate matëse me dekada rezistencash	
- për çdo dekade	2 000
4.6 Njehsorë elektrikë	
- njehsorë njëfazorë (energji aktive dhe reaktive)	3 000
- njehsorë shumëfazorë (energji aktive dhe reaktive)	4 000
- njehsorë elektrik me transformator	5 000
- njehsorë shumëtariforë	5 000.
5. Instrumente matëse dimensionale	
5.1 Instrumente matëse të gjatësisë	Lekë për copë
5.1.1 Metra	
- deri në 1 m	1 600

-mbi një metër	2 000
5.1.2 Metra shirit	1 200
- deri në 5 m	
- mbi 5 m deri 50 m	3 000
- mbi 50m	7 500
5.1.3 Komperator	2 000
5.1.4 Kalibër	1 000
5.1.5 Mikrometër	1 900.
6. Instrumente matëse të temperaturës	Lekë për copë
6.1 Termometër qelqi, në diapazonin – 60°C deri në 200°C	8 500
6.1.1 Për çdo termometër shtesë qelqi brenda diapazonit – 60°C deri në 200°C	7 500
6.1.2 Termometër qelqi, diapazoni – 60°C deri në 200°C, me ndarje 0.01 ose 0.02	10 000
6.2 Termometër me tregues dixhital/analog	9 500
6.2.1 Për çdo termometër dixhital/analog shtesë	8 000
6.2.3 Termometër me tregues dixhital/ analog – me ndarje 0.01 ose 0.02	12 000
Termometër me rezistencë	12 000
6.3.1 Për çdo termometër me rezistencë, shtesë	10 000
6.3.2 Termometër me rezistencë, me ndarje 0.01 ose 0.02	15 000
6.4 Termocifte	13 000
6.4.1 Për çdo termoçift shtesë brenda diapazonit – 70°C deri në 200°C	10 000
6.5 Banjo, furrë, termostat	15 000.

PASQYRA 5 MOSPLOTËSIME TË DETYRIMEVE

1. Puna për kalibrim të instrumentit matës në vendpërdorim:

- nuk mund të fillojë ose ndërpritet	merret 25% e pagesës përkatëse
- fillon me vonesë dhe për çdo orë punë të vonuar	paguhet 1000 lekë
2. Mos zbatimi i nje sherbimi të planifikuar	
- kur puna përgatitore nuk ka filluar	paguhet 3 % e pagesës përkatëse
- kur puna përgatitore ka filluar	paguhet 10 % e pagesës përkatëse
- kur puna përgatitore ka mbaruar	paguhet 20 % e pagesës përkatëse.

PASQYRA 6 TARIFAT E KONTROLLIT STATISTIKOR TË PRODUKTEVE TË PAKETUARA

1. Kontroll pa shkatërrim i produkteve të paketuara:	Lekë
1.1. Për partinë e produktit të parapaketuar 100 - 500 copë	8 000
1.2. Për partinë e produktit të parapaketuar 501- 3200 copë	11 000
1.3. Për partinë e produktit të parapaketuar 3201 e sipër	14 000
2.Kontroll me shkatërrim i produkteve të paketuara:	
2.1 Për sasinë e mostrave deri 20 copë	11 000

2.2 Për sasinë e mostrave mbi 20 copë	13 000.
3. Përcaktimi gjatë kontrollit i densitetit të produkteve të paketuara të lëngta dhe viskoze	
3.1 Përcaktimi i densitetit në vendin e kontrollit	3 000
3.2 Përcaktimi i densitetit në laborator	5 000
4. Miratimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe shisheve si enë matës	100 000
5. Monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse	30 000
6. Regjistrimi i prodhuesve dhe importuesve të parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse	500.

PASQYRA 7

Tarifat e procesit të autorizimit të subjekteve që kryejnë shërbime në fushën e metrologjisë ligjore, si dhe të inspektimit vjetor të tyre

1. Procesi i autorizimit të subjekteve të autorizuar për riparim	30000 lekë
2. Procesi i autorizimit të subjekteve për kryerje shërbimesh verifikimi dhe ekspertizë	50000 lekë.
3. Inspektimi (monitorimi) vjetor:	
- për subjektet riparuese	15000 lekë
- për subjektet për kryerje shërbimi dhe ekspertizë	25000 lekë.

UDHËZIM

Nr.1028, datë 10.12.2009

PËR PËRMBAJTJEN E DOKUMENTACIONIT PËR PAJISJE ME LEJE MINERARE

Në kuadër të reformës institucionale, bazuar në nenet 15 dhe 17 të ligjit mineral të Shqipërisë nr.7796, datë 17.2.1994, amenduar me ligjin nr.9261, datë 22.7.2004, në zbatim të neneve 25,26,31,33,45,47,64,65,70 dhe 71 të këtij ligji,

UDHËZOJ:

Miratimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë personi juridik për t'u pajisur me leje minerare për mineralet e grupit 1, 2, 3 dhe 4. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, paraqitet në sportelet e QKL-së. Sipas procedurës së përcaktuar në nenet 17, 31, 32 dhe 33 të ligjit 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

Dokumentacioni duhet të përmbajë:

1. Kërkesën për pajisje me leje minerare, duke përcaktuar saktësisht me koordinata zonën që kërkohet për shfrytëzim dhe sipërfaqen e saj. Përshkrimin e shkurtër dhe një hartë të shk.1:25 000 të zonës minerare:

- duke përcaktuar saktësisht koordinatat e saj në plan (X;Y) dhe në rastet e nevojshme edhe Z);

- sipërfaqen e saj.

2. Aktin e verifikimit, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), sipas formularit të përgatitur prej saj, për secilën nga llojet e lejes minerare të kërkuar. Në këtë formular të jenë pasqyruar edhe të dhënat nëse ka ose jo efekte të dëmshme për monumentet e kulturës apo të arkeologjisë.

3. Vendimin e QKR-së për regjistrimin si person juridik, ku në objektin e veprimtarisë të ketë miratuar edhe zhvillimin e aktivitetit minerar me punime sipërfaqësore ose nëntokësore sipas kërkesës.

4. Burimet financiare të nevojshme për mbulimin e investimeve që parashikohen të kryhen gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar.

4.1 Për personat juridikë që aplikojnë për leje minerare dhe që me vetëdeklarim sqarojnë se nuk kanë ushtruar më parë aktivitet minerar, ose ndonjë aktivitet tjetër biznesi, duhet të paraqesin burimet financiare me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Një deklaratë nga banka, që të konfirmojë se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku duhet të ketë të depozituara të paktën 30% të vlerës së investimit të parashikuar në programin e investimeve që ka paraqitur, dhe/ose;

- Një dokument që vërteton se personi juridik ka siguruar një kredi prej një banke, ose subjekti tjetër financiar me vlerë, e cila mbulon investimet që parashikohen të kryhen; dhe/ose

- Një kontratë me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit. Në këtë, rast personi juridik duhet të paraqesë një dokument noterial, në të cilin shprehet vullneti i investitorit për të mbështetur këtë investim, si dhe dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit (garanci bankare ose bilancet ekonomike të shoqërisë, në të cilën investitori është pronar i vetëm, ose aksionar maxhoritar).

4.2 Për personat juridikë që aplikojnë për leje minerare, të cilët kanë zhvilluar më parë aktivitet minerar, ose një aktivitet tjetër biznesi, si dokument për plotësimin e burimeve financiare do të konsiderohen:

- investimet kontabël që janë kryer;

- inventari fizik me zërat kryesorë të tij, si ndërtesa, makineri e pajisje kryesore etj.;

- bilanci financiar i vitit të fundit.

5. Për lejen e kërkimit të mineraleve të grupit 1, 2 dhe 3, kërkesa duhet të përmbajë kushtet e përcaktuara në nenin 25 të ligjit minerar të Shqipërisë.

6. Për lejen e zbulimit të mineraleve të grupit 1,2 dhe 3, kërkesa duhet të përmbajë kushtet e përcaktuara në nenin 31 të ligjit minerar të Shqipërisë.

7. Për lejen e kërkim-zbulimit të mineraleve të grupit 4, kërkesa duhet të përmbajë kushtet e përcaktuara në nenin 64 të ligjit minerar të Shqipërisë.

8. Për lejen e shfrytëzimit të mineraleve të grupit 1, 2 dhe 3, kërkesa duhet të përmbajë kushtet e përcaktuara në nenin 45 të ligjit minerar të Shqipërisë.

9. Për lejen e shfrytëzimit të mineraleve të grupit 4, kërkesa duhet të përmbajë kushtet e përcaktuara në nenin 70 të ligjit minerar të Shqipërisë.

10. Për lejen e shfrytëzimit të mineraleve të grupit 1, 2, 3 dhe 4, kërkesa duhet të përmbajë gjithashtu edhe:

10.1 Mendimin e pushtetit vendor të komunës ose bashkisë, për lejimin e zhvillimit të aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mineralit në objektin që kërkohet. Në rastet kur toka është pronë private, personi juridik duhet të paraqesë marrëveshjen me pronarin e tokës për lejimin e shfrytëzimit.

10.2 Mendimin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të rrethit për lejimin e zhvillimit të aktivitetit minerar në objektin që kërkohet të shfrytëzohet, për rastin kur objekti është në fondin pyjor.

10.3 Lejen mjedisore të lëshuar nga QKL-ja. Leja mjedisore mund të jepet edhe për një sipërfaqe më të vogël se ajo që kërkohet për lejen minerare, por që është pjesë e saj, me kusht që:

- shfrytëzimi i minierës të fillojë nga kjo sipërfaqe;

- përpara se të fillojë shfrytëzimi jashtë kësaj sipërfaqeje, të merret leje e re mjedisore, e cila dorëzohet në AKBN.

10.4 Kontratën me drejtuesin teknik të punimeve, i cili duhet të jetë inxhinier miniere, me përjashtim të rasteve kur nuk përdoret lëndë plasëse, mund të jetë edhe inxhinier gjeolog.

10.5 Studimin tekniko-ekonomik dhe për rastin e lejeve të shfrytëzimit, projektin e shfrytëzimit të objektit të hartuar nga specialistë të certifikuar nga AKBN, të fushës gjeologo-minerare dhe markshderike.

Vendimi i këshillit teknik në AKBN të shprehet qartë në lidhje me studimin tekniko-ekonomik dhe projektin e shfrytëzimit të objektit minerar, të paraqitur nga subjekti, ku të konfirmohet garantimi i zhvillimit normal të programit të punës dhe plotësimi i të gjitha kërkesave të sigurimit teknik në minierë.

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet QKL-ja, AKBN-ja dhe Drejtoria e Koordinimit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore.

Udhëzimi i Ministrit nr.5/1, datë 5.2.2007 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Dritan Prifti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbraja ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 2.4.2010
Doli nga shtypi më 5.4.2010

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë